

VENDIM
Nr. 182, datë 9.3.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 860, DATË 10.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË MBLEDHJES DHE ADMINISTRIMIT TË TË ARDHURAVE PËR NDËRTIMET PA LEJE DHE VLERAVE TË ZBATUESHME PËR LEGALIZIM"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32, pika 3, e 43, pika 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Pika 4 ndryshohet me këtë përmbajtje:

"4. Pagesa e tarifës së shërbimit të kryhet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit me shkrim të ALUIZNI-t."

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

"4/1. Për ndërtimet pa leje, njoftimi për pagesën e tarifës së shërbimit (në rastet kur kjo tarifë aplikohet), i dërgohet subjektit në rrugë postare ose i jepet në dorëzim menjëherë pas kualifikimit të ndërtimit për legalizim (data e vendimit të kualifikimit).

Në rast mospagimi të tarifës, ALUIZNI, pas miratimit të lejes së legalizimit, e dërgon atë për regjistrim me hipotekë ligjore mbi ndërtimin, sipas nenit 54, të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

"6. Për llogaritjen e penalitetit të legalizimit të shtesave të subjektit ndërtues, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, si çmim minimal fiskal të përdoret vlera e kostos mesatare të ndërtimit të banesave për m², bazuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, të miratuar në zbatim të shkronjës "dh", të nenit 34/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004. "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar."

4. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Për ndërtimet në zona ku nuk ka vlera të miratuara të kostos mesatare, për llogaritja të kryhet në bazë të mesatares aritmetike të kostove të zonave kufitare."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama